



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA LEZHE

Nr. _____ Prot.

Lezhë, më ____/____/2025

Shtojca 12.

[Shtojcë për tu plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

**FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT, PAS PUBLIKIMIT TË TË CILIT
FILLOJNË AFATET E ANKIMIMIT**

Data 17/07/2025

Drejtuar:

Operatorit Ekonomik (OE)

X ose

“ASI-2A CO” Shpk, me Nuis K53002402C dhe me adrese Rruga “Skenderbeu”, Lagjia “Bishanake”, pallati nr. 18, hyrja nr. 6, Fier.

Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë (BOE) ☐

- OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐

JO X

-OE/BOE me Subjekt Mbështetës:

PO ☐

JO X

Tipi i Kontratës: Pune.

Lloji i Procedurës së prokurimit: E Hapur.

Numri i Procedurës / referenca e Lotit: REF-48772-05-23-2025

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: “Rikonstruksioni i shkolles 9-vjeçare “Gjergj Fishta”, Lezhe”.

Kohëzgjatja e kontratës: 6 muaj nga data e nenshkrimit te kontrates.

Data e Publikimit të Njoftimit të Kontratës në SPE: 02/06/2025.

Data e Publikimit të Njoftimit të Kontratës në Buletinin e Njoftimeve Publike: Buletini Nr. 29, datë 9 Qershor 2025.

KRITERET E PËRZGJEDHJES SË FITUESIT:

- oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në kosto ☐
- oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim X

Me anë të këtij Formulari ju informojmë se, në këtë procedurë/lot kanë marrë pjesë, Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. Operatori Ekonomik “ALBA KONSTRUKSION” SH.P.K, me NUIS J61812013R dhe me oferte ekonomike 152,597,638.56 (nje qind e pesedhjetë e dy milion e peseqind e nentëdhjetë e shtatë mijë e gjashtëqind e tridhjetë e tetë pike pesedhjetë e gjashtë) Lek pa TVSH,
OE/BOE me nënkontraktor
PO ☐ JO X

2. Operatori Ekonomik “ASI-2A CO” SH.P.K, me NUIS K53002402C dhe me oferte ekonomike 146,000,000 (njqind e dyzet e gjashtë milione) Lek pa TVSH,
OE/BOE me nënkontraktor
PO ☐ JO X

3. Operatori Ekonomik “B93 II” SH.P.K, me NUIS L52209050O dhe me oferte ekonomike 153,168,150.62 (njqind e pesedhjetë e tre milion e njqind e gjashtëdhjetë e tetë mijë e njqind e pesedhjetë pike gjashtëdhjetë e dy) Lek pa TVSH,
OE/BOE me nënkontraktor
PO ☐ JO X

4. Bashkimi i Operatoreve Ekonomik “DESARET COMPANY” SH.P.K, me Nuis K01816001J & “REJ” SH.P.K me Nuis J93711608Q, dhe me oferte ekonomike 127,737,833.85 (njëqind e njëzet e shtatë milion e shtatëqind e tridhjetë e shtatë mijë e tetëqind e tridhjetë e tre pikë tetëdhjetë e pesë) Lek pa TVSH,
OE/BOE me nënkontraktor
PO ☐ JO X

5. Operatori Ekonomik “DION-AL” SH.P.K, me Nuis K67917301H dhe me oferte ekonomike 138,037,467.03 (njqind e tridhjetë e tetë milion e tridhjetë e shtatë mijë e katerqind e gjashtëdhjetë e shtatë pike zero tre) Lek pa TVSH,
OE/BOE me nënkontraktor
PO ☐ JO X

6. Operatori Ekonomik “Eduart Çela” P/F me NUIS M03806202I dhe pa oferte ekonomike,
OE/BOE me nënkontraktor
PO ☐ JO X

7. Operatori Ekonomik “ERGI” SH.P.K, me NUIS K02727229P dhe me oferte ekonomike 153,310,157.54 (njqind e pesedhjetë e tre milion e treqind e dhjetë mijë e njqind e pesedhjetë e shtatë pike pesedhjetë e kater) Lek pa TVSH,
OE/BOE me nënkontraktor
PO ☐ JO X

8. Operatori Ekonomik “INA” SH.P.K me NUIS J61814009W dhe me oferte ekonomike 108,297,388 (njëqind e tetë milion e dyqind e nëntëdhjetë e shtatë mijë e treqind e tetëdhjetë e tetë) Lek pa TVSH,
OE/BOE me nënkontraktor
PO ☐ JO ☒
9. Operatori Ekonomik “JUNIK” SH.P.K me NUIS J68007522L dhe me oferte ekonomike 136,551,612.84 (njëqind e tridhjetë e gjashtë milion e pesëqind e pesëdhjetë e një mijë e gjashtëqind e dymbëdhjetë pike tetëdhjetë e katër) Lek pa TVSH,
OE/BOE me nënkontraktor
PO ☐ JO ☒
10. Operatori Ekonomik “LLAZO” SH.P.K, me NUIS K24218401K dhe me oferte ekonomike 150,299,728 (njëqind e pesëdhjetë milion e dyqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e shtatëqind e njëzet e tetë) Lek pa TVSH,
OE/BOE me nënkontraktor
PO ☐ JO ☒
11. Operatori Ekonomik “NDREGJONI” SH.P.K me NUIS K31329048I dhe me oferte ekonomike 151,997,639 (njëqind e pesëdhjetë e një milion e nëntëqind e nëntëdhjetë e shtatë mijë e gjashtëqind e tridhjetë e nëntë) Lek pa TVSH,
OE/BOE me nënkontraktor
PO ☐ JO ☒
12. Bashkimi i Operatoreve Ekonomik “RRUGA URA ASFALTIM NR.2 ELBASAN” SH.P.K me NUIS J62904264O & “ZEQILLARI” SH.P.K me NUIS L61912024O & “BLERIMI” SH.P.K, me NUIS J62903384G & “KEVIN KONSTRUKSION” SH.P.K, me Nuis K71401004W dhe me oferte ekonomike 135,623,283.53 (njëqind e tridhjetë e pesë milion e gjashtëqind e njëzet e tre mijë e dyqind e tetëdhjetë e tre pike pesëdhjetë e tre) Lek pa TVSH,
OE/BOE me nënkontraktor
PO ☐ JO ☒
13. Operatori Ekonomik “Shendelli” SH.P.K, me Nuis K07924803N dhe me oferte ekonomike 150,787,844.74 (njëqind e pesëdhjetë milion e shtatëqind e tetëdhjetë e shtatë mijë e tetëqind e dyzet e katër pike shtatëdhjetë e katër) Lek pa TVSH,
OE/BOE me nënkontraktor
PO ☐ JO ☒

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar, Ofertuesit e mëposhtëm:

I- Operatori Ekonomik “ALBA KONSTRUKSION” SH.P.K, me NUIS J61812013R,

OE/BOE me nënkontraktor

Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik rezulton se:

Se pari, nuk ka paraqitur sigurimin e ofertes sipas shtojces 3,

KVO bazuar në nenin 83, të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet se: *1. Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël. Në rastin e kontratave sektoriale, enti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, ndërkohë që mund të kërkojë paraqitjen e këtij sigurimi edhe në procedurat nën kufirin e lartë monetar, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël.*

Si dhe në nenin 30, të VKM-se 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, parashikohet se: *“1Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël, sikurse përcaktohet në nenin 83, të LPP-së. Enti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël, sikurse përcaktohet në nenin 83, të LPP-së. Enti kontraktor, sipas vlerësimit të tij, mund të kërkojë ose jo sigurim oferte për procedurat nën kufirin e lartë monetar. 2. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor pranon mundësinë e pagesës së vlerës së sigurimit, nga ofertuesi, në vlerë monetare në llogarinë e autoritetit/entit kontraktor. Përveç kësaj forme të paraqitjes së sigurimit të ofertës, sigurimi i ofertës mund të ketë formën e një depozite apo garancie, të lëshuar nga një bankë ose një shoqëri sigurimi, e licencuar nga shteti për të ushtruar këtë veprimtari”,*

Sa me sipër KVO, vlereson se për të përmbushur këto kriter OE-te duhet të paraqesin sigurimin e ofertës në formën e një depozite apo garancie, të lëshuar nga një bankë ose një shoqëri sigurimi e cila duhet të jetë e neshkruar nga Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit.

Nga verifikimi i dokumentacionit në SPE, rezulton se OE nuk ka ngarkuar në SPE sigurimin e ofertes sipas shtojces 3, duke e bërë të pa përmbushur këto kriter.

Se dyti, nuk plotëson kriterin 2.3.10 të DST-se ku parashikohet se: **“Operatori ekonomik në rast se nuk është prodhues duhet të paraqesë kontratë e furnizimit për materialet si më poshtë:**

2.3.10/1 Për Bojrat dhe Gipsin

- Kontrate paraprake furnizimi me prodhuesin ose distributorin e autorizuar. Në rast paraqitje kontrate furnizimi me distributorin zyrtar, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë autorizimin/aktin e marrëveshjes ose çdo dokument tjetër që provon lidhjen midis prodhuesit dhe distributorit zyrtar.

2.3.10/2 Për Materialet e termoizolimit, hidroizoluese dhe suvase:

- Kontrate paraprake furnizimi me prodhuesin ose distributorin e autorizuar. Në rast paraqitje kontrate furnizimi me distributorin zyrtar, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë

autorizimin/aktin e marrëveshjes ose cdo dokument tjetër që provon lidhjen midis prodhuesit dhe distributorit zyrtar.

2.3.10/3 Per Materialet Elektrike:

- Kontrate paraprake furnizimi me prodhuesin ose distributorin e autorizuar. Në rast paraqitje kontrate furnizimi me distributorin zyrtar, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë autorizimin/aktin e marrëveshjes ose cdo dokument tjetër që provon lidhjen midis prodhuesit dhe distributorit zyrtar.

2.3.10/4 Per Materialet Hidraulike:

- Kontrate paraprake furnizimi me prodhuesin ose distributorin e autorizuar. Në rast paraqitje kontrate furnizimi me distributorin zyrtar, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë autorizimin/aktin e marrëveshjes ose cdo dokument tjetër që provon lidhjen midis prodhuesit dhe distributorit zyrtar.

2.3.10/5 Per Hekurin

- Kontrate paraprake furnizimi me prodhuesin ose distributorin e autorizuar. Në rast paraqitje kontrate furnizimi me distributorin zyrtar, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë autorizimin/aktin e marrëveshjes ose cdo dokument tjetër që provon lidhjen midis prodhuesit dhe distributorit zyrtar.

2.3.10/6 Per Pajisjet e Kondicionimit

- Kontrate paraprake furnizimi me prodhuesin ose distributorin e autorizuar. Në rast paraqitje kontrate furnizimi me distributorin zyrtar, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë autorizimin/aktin e marrëveshjes ose cdo dokument tjetër që provon lidhjen midis prodhuesit dhe distributorit zyrtar.

2.3.10/7 Per Ashensorin

- Kontrate paraprake furnizimi me prodhuesin ose distributorin e autorizuar. Në rast paraqitje kontrate furnizimi me distributorin zyrtar, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë autorizimin/aktin e marrëveshjes ose cdo dokument tjetër që provon lidhjen midis prodhuesit dhe distributorit zyrtar.

Nga analizimi i Dokumentave standarte të tenderit vërehet se për vendosjen e këtij kriteri Autoriteti Kontraktor është bazuar në zërat e preventivit të punimeve që do të realizohen dhe rendesise të vecante të objektit të prokurimit duke vlerësuar si të nevojshme që mallrat që do të perdoren në realizimin e punimeve të furnizohen nga prodhues apo distributor të autorizuar, kjo në përputhje me kërkesat ligjore të parashikuara në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe në nenin 39, pika 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”,

Sa analizuar me siper dhe pas shqyrtimit të kriterit dhe qëllimit të vendosjes së tij nga ana e Autoritetit Kontraktor, KVO vëren se për përmbushjen e këtij kriteri OE-te në rast se **nuk janë**

prodhues duhet te paraqesin, **kontrate paraprake furnizimi me prodhuesin ose distributorin e autorizuar**.

Në rast paraqitje kontrate furnizimi me distributorin zyrtar, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë autorizimin/ aktin e marrëveshjes ose cdo dokument tjetër që provon lidhjen midis prodhuesit dhe distributorit zyrtar. Per Dokumentacionin ne gjuhe te huaj Operoret ekonomike duhet te perkthejne kete dokumentacion ne gjuhen shqipe.

Komisioni i Vleresimit te Ofertave veren se per permbushjen e ketij kriteri operoret ekonomike duhet te paraqesin per secilin nga materialet e kerkuar: Kontrate paraprake furnizimi me prodhuesin ose distributorin e autorizuar. Në rast paraqitje kontrate furnizimi me distributorin zyrtar, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë autorizimin/aktin e marrëveshjes ose cdo dokument tjetër që provon lidhjen midis prodhuesit dhe distributorit zyrtar.

Nga verifikimi ne SPE rezulton se OE nuk ka paraqitur asnje dokumentacion që provon permbushjen e ketij kriteri.

Se treti, nuk ploteson kriterin 2.3.11 te DST-se ku parashikohet se: “Operatori ekonomik duhet të dorëzojë katalog/fragment katalogu/ skede teknike, per mallrat e meposhtem:

Nr	Emertimi i Mallit
1	Ashensori
2	Njesi e jashtme kondicionimi me kompresor inverter
3	Panel Diellore 300l
4	FV UPS 30kVA 3:3(3-fazor) me autonomi 10min

Katalogu/fragment katalogu/ skede teknike duhet te markohet ne menyre te qarte dhe te dallueshme secili nga artikujt e mesiperme sipas modelit te deklaruar dhe te shenohen per te gjithë artikujt e mesiperme.

Theksojme se per te permbushur piken 2.3.11, ne lidhje me dorëzimin e katalog/fragment katalogu/ skede teknike per mallrat e kerkuara, OE duhet te paraqesin ne SPE Katalog/fragment katalogu/ skede teknike dhe per secilin nga mallrat duhet te markohet ne menyre te qarte dhe te dallueshme.

Nga verifikimi ne SPE rezulton se nuk ka asnje dokumentacion që provon permbushjen e ketij kriteri.

Se katerti, nuk ploteson kriterin 2.3.13 te DST-se ku parashikohet se: “Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë deklaratën ku të shprehet se është dakort me mënyrën e financimit të objektit dhe se punimet për realizimin e këtij objekti do të përfundojnë brenda afatit të përcaktuar nga autoriteti kontraktor”.

KVO thekson se per permbushjen e ketij kriteri operatorët ekonomike duhet te paraqesin **deklaratën** ku të shprehet se është dakort me mënyrën e financimit të objektit dhe se punimet për realizimin e këtij objekti do të përfundojnë brenda afatit të përcaktuar nga autoriteti kontraktor

Nga verifikimi I dokumentacionit ne SPE rezulton se nuk ka paraqitur asnje dokumentacion per permbushjen e ketij kriteri.

Sa me siper Komisioni i Vleresimit te Ofertave mbështetur nenin 77, pika 1, 4 dhe 5, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës. 4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës. 5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve, si dhe ne në nenin 92, pika 3 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet: “Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji”, vendosi te refuzoje oferten e OE “ALBA KONSTRUKSION” SH.P.K, per mos permbushje te kriterëve te vecanta kualifikuese.

Si perfundim, në mbështetje të nenit 92, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, OE “ALBA KONSTRUKSION” SH.P.K, me NUIS J61812013R, skualifikohet.

II- Operatori Ekonomik “B93 II” SH.P.K, me NUIS L52209050O,

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

Nga verifikimi i dokumentacionit te paraqitur nga operatori ekonomik rezulton se:

Se pari, nuk ka paraqitur sigurimin e ofertes sipas shtojces 3,

KVO bazuar ne nenin 83, te ligjit nr.162/2020 “Per prokurimin publik”, parashikohet se: 1. Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël. Në rastin e kontratave sektoriale, enti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, ndërkohë që mund të kërkojë paraqitjen e këtij sigurimi edhe në procedurat nën kufirin e lartë monetar, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël.

Si dhe ne nenin 30, te VKM-se 285, date 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, parashikohet se: “1Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël, sikurse përcaktohet në nenin 83, të LPP-së. Enti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël, sikurse përcaktohet në nenin 83, të LPP-së. Enti kontraktor, sipas vlerësimit të tij, mund të kërkojë ose jo sigurim oferte për procedurat nën kufirin e lartë monetar. 2. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor pranon mundësinë e pagesës së vlerës së sigurimit, nga ofertuesi, në vlerë monetare në llogarinë e autoritetit/entit kontraktor. Përveç kësaj forme të paraqitjes së sigurimit të ofertës, sigurimi i ofertës mund të ketë formën e një depozite apo garancie, të lëshuar nga një bankë ose një shoqëri sigurimi, e licencuar nga shteti për të ushtruar këtë veprimtari”,

Sa me siper KVO, vlereson se per te permbushur kete kriter OE-te duhet te paraqesin sigurimin e ofertës ne formën e një depozite apo garancie, të lëshuar nga një bankë ose një shoqëri sigurimi e cila duhet te jete e neshkruar nga Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit.

Nga verifikimi i dokumentacionit ne SPE, rezulton se OE nuk ka ngarkuar ne SPE sigurimin e ofertes sipas shtojces 3, duke e bere te pa përmbushur kete kriter.

Se dyti, nuk ploteson kriterin 2.3.4 te DST-se ku parashikohet se: “Operatoret Ekonomike duhet te kene pjese te stafit teknik te shoqerise dhe te figuroje ne Licensen e kompanise si me poshte:

- Inxhinier Ndërtimi	1 (nje)	Diplome Universitare
- Inxhinier Elektrik	1 (nje)	Diplome Universitare
- Inxhinier Hidroteknik	1 (nje)	Diplome Universitare
- Inxhinier Mekanik	1 (nje)	Diplome Universitare
- Inxhinier Elektronik	1 (nje)	Diplome Universitare
- Inxhinier Mjedisi	1 (nje)	Diplome Universitare
- Inxhinier Gjeodet/Topograf/Gjeomatik	1 (nje)	Diplome Universitare
- Arkitekt	1 (nje)	Diplome Universitare

-Per stafin e mesiperm Operatori ekonomik duhet te paraqese dokumentacionin si me poshte: Kontratë pune e vlefshme, Diploma Universitare si dhe të figurojnë ne listepagesat e kompanise se minimalisht per periudhen Shkurt 2025 - Prill 2025.

Shenim: Kjo kerkese permbushet nepermjet paraqitjes nga operatoret ekonomik te formularit permbledhes te vetedeklarimit sipas shtojces perkatese te DST-se dhe dokumentacioni i kerkuar

duhet te paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar, i pari perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe fillimit te afateve te ankimimit.

KVO veren se bazuar ne piken 1 te nenit 26, te VKM-se nr. 285 date 19.05.2021 “Per miratimin e rregullave te prokurimit publik”, i ndryshuar, parshikohet se: *Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si prove paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose pale te treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla, dhe per te permbushur kete kriter operatoret ekonomik pjesmarres duhet te vetedeklarojne ne formularin permbledhes te vetedeklarimit sipas shtojces perkatese te DST-se, te dhenat e stafit teknik qe disponon sipas percaktimeve te pikes 2.3.4 te DST-se.*

Nga verifikimi i dokumentacionit te paraqitur ne SPE, verehet se operatori ekonomik nuk disponon drejtuesit teknik konkretisht inxhinierin **Mekanik, Elektronik dhe Arkitekt**, pasi nuk ka deklaruar ne formularin permbledhes te vetedeklarimit diponimin e tyre.

Sa me siper duke qene se OE nuk ka deklaruar ne formularin permbledhes te vetedeklarimit diponimin e inxhinierit Elektrik dhe Gjeodet/Topograf, ky kriter konsiderohet i papermbushur.

Se treti, nuk ploteson kriterin 2.3.10 te DST-se ku parashikohet se: **“Operatori ekonomik ne rast se nuk eshte prodhues duhet te paraqese kontrat e furnizimit per materialet si me poshte:**

2.3.10/1 Per Bojrat dhe Gipsin

- Kontrate paraprake furnizimi me prodhuesin ose distributorin e autorizuar. Në rast paraqitje kontrate furnizimi me distributorin zyrtar, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë autorizimin/aktin e marrëveshjes ose cdo dokument tjetër që provon lidhjen midis prodhuesit dhe distributorit zyrtar.

2.3.10/2 Per Materialet e termoizolimit, hidroizoluese dhe suvase:

- Kontrate paraprake furnizimi me prodhuesin ose distributorin e autorizuar. Në rast paraqitje kontrate furnizimi me distributorin zyrtar, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë autorizimin/aktin e marrëveshjes ose cdo dokument tjetër që provon lidhjen midis prodhuesit dhe distributorit zyrtar.

2.3.10/3 Per Materialet Elektrike:

- Kontrate paraprake furnizimi me prodhuesin ose distributorin e autorizuar. Në rast paraqitje kontrate furnizimi me distributorin zyrtar, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë autorizimin/aktin e marrëveshjes ose cdo dokument tjetër që provon lidhjen midis prodhuesit dhe distributorit zyrtar.

2.3.10/4 Per Materialet Hidraulike:

- Kontrate paraprake furnizimi me prodhuesin ose distributorin e autorizuar. Në rast paraqitje kontrate furnizimi me distributorin zyrtar, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë autorizimin/aktin e marrëveshjes ose cdo dokument tjetër që provon lidhjen midis prodhuesit dhe distributorit zyrtar.

2.3.10/5 Per Hekurin

- Kontrate paraprake furnizimi me prodhuesin ose distributorin e autorizuar. Në rast paraqitje kontrate furnizimi me distributorin zyrtar, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë autorizimin/aktin e marrëveshjes ose cdo dokument tjetër që provon lidhjen midis prodhuesit dhe distributorit zyrtar.

2.3.10/6 Per Pajisjet e Kondicionimit

- Kontrate paraprake furnizimi me prodhuesin ose distributorin e autorizuar. Në rast paraqitje kontrate furnizimi me distributorin zyrtar, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë autorizimin/aktin e marrëveshjes ose cdo dokument tjetër që provon lidhjen midis prodhuesit dhe distributorit zyrtar.

2.3.10/7 Per Ashensorin

- Kontrate paraprake furnizimi me prodhuesin ose distributorin e autorizuar. Në rast paraqitje kontrate furnizimi me distributorin zyrtar, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë autorizimin/aktin e marrëveshjes ose cdo dokument tjetër që provon lidhjen midis prodhuesit dhe distributorit zyrtar.

Nga analizimi i Dokumentave standarte të tenderit verëhet se për vendosjen e këtij kriteri Autoriteti Kontraktor është bazuar në zërat e preventivit të punimeve që do të realizohen dhe rendesise të vecante të objektit të prokurimit duke vlerësuar si të nevojshme që mallrat që do të perdoren në realizimin e punimeve të furnizohen nga prodhues apo distributor të autorizuar, kjo në përputhje me kërkesat ligjore të parashikuara në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe në nenin 39, pikë 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”,

Sa analizuam me siper dhe pas shqyrtimit të kriterit dhe qëllimit të vendosjes së tij nga ana e Autoritetit Kontraktor, KVO verën se për përmbushjen e këtij kriteri OE-te në rast se **nuk janë prodhues** duhet të paraqesin, **kontrate paraprake furnizimi me prodhuesin ose distributorin e autorizuar**.

Në rast paraqitje kontrate furnizimi me distributorin zyrtar, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë autorizimin/ aktin e marrëveshjes ose cdo dokument tjetër që provon lidhjen midis prodhuesit dhe distributorit zyrtar. Për Dokumentacionin në gjuhë të huaj Operoret ekonomike duhet të përkthejnë këtë dokumentacion në gjuhën shqipe.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave verën se për përmbushjen e këtij kriteri operoret ekonomike duhet të paraqesin për secilin nga materialet e kërkuar: Kontrate paraprake furnizimi me prodhuesin ose distributorin e autorizuar. Në rast paraqitje kontrate furnizimi me distributorin zyrtar, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë autorizimin/aktin e marrëveshjes ose cdo dokument tjetër që provon lidhjen midis prodhuesit dhe distributorit zyrtar.

Nga verifikimi ne SPE rezulton se OE nuk ka paraqitur asnje dokumentacion qe provon permbushjen e ketij kriteri.

Se katerti, nuk ploteson kriterin 2.3.13 te DST-se ku parashikohet se: “*Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë deklaratën ku të shprehet se është dakort me mënyrën e financimit të objektit dhe se punimet për realizimin e këtij objekti do të përfundojnë brenda afatit të përcaktuar nga autoriteti kontraktor*”.

KVO thekson se per permbushjen e ketij kriteri operatorët ekonomike duhet te paraqesin **deklaratën** ku të shprehet se është dakort me mënyrën e financimit të objektit dhe se punimet për realizimin e këtij objekti do të përfundojnë brenda afatit të përcaktuar nga autoriteti kontraktor

Nga verifikimi I dokumentacionit ne SPE rezulton se nuk ka paraqitur asnje dokumentacion per permbushjen e ketij kriteri.

Sa me siper Komisioni i Vleresimit te Ofertave mbeshtetur nenin 77, pika 1, 4 dhe 5, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës. 4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës. 5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për permbushjen e këtyre kriterëve, si dhe ne në nenin 92, pika 3 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet: “Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji”, vendosi te refuzoje oferten e OE “B93 II” SH.P.K, per mos permbushje te kriterëve te vecanta kualifikuese.

Si perfundim, në mbështetje të nenit 92, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, OE “B93 II” SH.P.K, me NUIS L52209050O, skualifikohet.

III- Bashkimi i Operatoreve Ekonomik “DESARET COMPANY” SH.P.K, me Nuis K01816001J & “REJ” SH.P.K me Nuis J93711608Q,

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

Nga verifikimi i dokumentacionit ne SPE rezulton se OE ka dorezuar te gjithë dokumentacionin ne perputhje me kriteret e pergjithshme dhe te vecanta te kualifikimit te percaktuar ne dokumentat standarte te tenderit.

Komisioni i vleresimit te ofertave mbeshketur në nenin 92, pika 3, ligjit nr.162/2020, “Për prokurimin publik”, ku parashikohet shprehimisht se: Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji.

Oferta konsiderohet e vlefshme edhe nëse ajo përmban devijime të vogla, të cilat nuk ndryshojnë thelbësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, gabime shtypi, të cilat mund të korrigjohen pa prekur përmbajtjen e saj, si edhe ato të lidhura me informacionet që merren lehtësisht nga dokumente faktike, që tregojnë gjendjen e operatorit ekonomik në kohën e ofertimit.

Per sa me siper oferta e dorezuar nga BOE “DESARET COMPANY” SH.P.K, me Nuis K01816001J & “REJ” SH.P.K me Nuis J93711608Q, eshte kualifikuar.

Ne vijim me date 09/07/2025, Komisioni i Vleresimit te Ofertave u mblodh per vleresimin e dokumentacionit te paraqitur prane Bashkise Lezhe nga BOE “DESARET COMPANY” SH.P.K, & “REJ” SH.P.K duke mbajtur ne konsiderate se:

- I. Komisioni i Vleresimit te Ofertave pas vleresimit te dokumentacionit te paraqitur ne SPE **ka vendosur te kualifikojë paraprakisht oferten e paraqitur nga BOE “DESARET COMPANY” SH.P.K, & “REJ” SH.P.K.***
- II. KVO ne daten 04.07.2025, pas vleresimit te dokumentacionit te paraqitur ne SPE, i kerkoi Bashkimit te Operatoreve Ekonomik “DESARET COMPANY” SH.P.K, & “REJ” SH.P.K, te klasifikuar i pari, te dorezoje dokumentet provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2, të nenit 26, te VKM-se nr. 285, date 19.05.2021 “Per miratimin e rregulave te prokurimit publik” te ndryshuar, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike me date 17.06.2025,*

.... **dhe** bazuar ne piken 1 dhe 5, te nenit 82, te Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar parashikohet se:

1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet

publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik. Kur autoriteti ose enti kontraktor mund t'i marrë dokumentet mbështetëse duke u futur direkt në një bazë të aksesueshme të dhënash shtetërore, në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit përcaktohet edhe informacioni që kërkohet për këtë qëllim, siç është adresa në internet e bazës të të dhënave, çdo e dhënë identifikimi dhe, sipas rastit, në deklaratën e nevojshme për dhënien e pëlqimit. Operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.

5. Në çdo rast, përpara se të japë kontratën, autoriteti ose enti kontraktor duhet t'i kërkojë ofertuesit fitues që të dorëzojë:

- a) dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike, të cilat në kohën e dorëzimit pranë autoritetit kontraktor duhet të jenë në origjinal ose kopje të noterizuara të tyre;
- b) dokumentet mbështetëse në origjinal ose një kopje të noterizuar të tyre për vetëdeklarimet e dhëna.

si dhe bazuar piken 1 dhe 6 te nenit 26, te VKM-së Nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, ku parashikohet se:

1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.

6. Në procedurat e prokurimit me një fazë, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i” dhe “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.

Në procedurat e prokurimit me faza, ky dokumentacion i kërkohet të gjithë kandidatëve të kualifikuar në fazën e parë, përpara nisjes së afateve të ankimit.

Ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të dorëzojë dokumentat provuese, të cilat duhet të jenë në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin.

Për dokumentat e ofertës, të ngarkuara në sistemin e prokurimit elektronik, ofertuesi i kualifikuar i pari duhet t'i paraqesë këto dokumenta në origjinal ose të njësuar me origjinalin.

Gjithashtu, dokumentet provuese, që do të paraqiten për të provuar vetëdeklarimet e bëra, duhet të paraqiten në origjinal ose të njësuar me origjinalin dhe të provojnë gjendjen faktike të ofertuesit në kohën e ofertimit të tij.

Autoriteti/enti kontraktor pranon një dokument të lëshuar nga i njëjti institucion ose palë e tretë dhe që ka të njëjtin informacion me atë të paraqitur në procedurën e zhvilluar në mënyrë elektronike.

Operatorët ekonomikë të huaj duhet të paraqesin dokumentet në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit të lëshuar në një shtet të huaj. Për dokumentet që nuk lëshohen në vendin e origjinës, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë këtë fakt, përndryshe dokumentacioni do të konsiderohet i paparaqitur.

KVO verën se pas njoftimit nga ana e AK-se për dorezimin e dokumentacionit të ofertes është paraqitur BOE “DESARET COMPANY” SH.P.K & “REJ” SH.P.K dhe ka dorezuar me datë 08.07.2025 pranë Bashkisë Lezhe dokumentacionin fizik të parashikuar në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i” dhe “j”, të pikës 2, të nenit 26, të VKM-se nr. 285, datë 19.05.2022 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike me datë 17.06.2025.

Sa me sipër, Komisioni i Vleresimit të Ofertave pas marrjes në dorezim të dokumentacionit të dorëzuar pranë Bashkisë Lezhe me shkresën nr. 12249 protokollin hyrës, me datë 08.07.2025 nga BOE “DESARET COMPANY” SH.P.K & “REJ” SH.P.K si dhe bazuar në nenin 82, të VKM-se nr. 285, datë 19.05.2022 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, mori në shqyrtim dokumentacionin e dorëzuar ku konstatoi se:

Se pari, nuk ka paraqitur Formularin Permbeledhës të Vetedeklarimit sipas shtojcës 8, për operatorin ekonomik “REJ” SH.P.K i cili është njeri nga anëtarët e Bashkimit të Operatoreve Ekonomike.

KVO verën se kriteret e vecanta të kualifikimit parashikohet se “1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetedeklarimit, sipas Shtojcës 8;

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3”;

Po ashtu, KVO verën se bazuar në pikën 1 të nenit 26, të VKM-se nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parshikohet se: *Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si prove paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose pale të treta, formularin përmbledhës të vetedeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla, dhe për të përmbushur këto kriter operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesin formularin përmbledhës të vetedeklarimit sipas shtojcës perkatese të DST-se.*

Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur pranë Bashkisë Lezhe rezulton se operatori ekonomik “REJ” SH.P.K i cili është pjesë e BOE-se nuk ka paraqitur Formularin Permbeledhës të Vetedeklarimit.

Sa me sipër duke qenë se njeri nga anëtarët e Bashkimit të Operatoreve Ekonomik nuk ka paraqitur formularin përmbledhës të vetedeklarimit, ky kriter konsiderohet i papërmbushur.

Se dyti, nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion provues që ka shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike për operatorin ekonomik “REJ” SH.P.K i cili është njeri nga anetarët e Bashkimit të Operatoreve Ekonomike.

KVO mban në konsideratë se në piken 7, të nenit 39, të VKM-së 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar në “Kërkesa të vecanta për kontratat për punë publike” parashikohet se: *“Për të provuar se operatori ekonomik vepron konform kërkesave të legjislacionit në fuqi, autoriteti/enti kontraktor kërkon që: a) Operatori ekonomik të ketë shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike, dhe përmbush kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni i fushës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë.*

Po ashtu KVO mban në konsideratë se në nenin 26, të VKM-së 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, parashikohet se:

1. *Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.*

2. *Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit përmban informacion dhe deklarin, si më poshtë vijon:*

e) operatori ekonomik ka shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike, dhe përmbush kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni i fushës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë;

6. *Në procedurat e prokurimit me një fazë, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i” dhe “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.*

KVO thekson se për përmbushjen e këtij kriteri operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetimin që ka shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike dhe në rastin e Bashkimit të Operatoreve Ekonomike cdo anëtar duhet të paraqesë vërtetimin përkatës.

Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur pranë Bashkisë Lezhe rezultoi se operatori ekonomik “REJ” SH.P.K i cili është pjesë e BOE-së nuk ka paraqitur vërtetimin që ka shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike.

Sa më sipër duke qenë se njeri nga anetarët e Bashkimit të Operatoreve Ekonomikë nuk ka paraqitur vërtetimin që ka shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike, ky kriter konsiderohet i papërmbushur.

Se treti, nuk plotëson kriterin 2.2.3 të DST-së ku parashikohet se: *“Operatorët Ekonomikë ofertues duhet të paraqesin një dokument që vërteton se ka paguar të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave*

vendore lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore për të gjitha vendet ku operatori ushtron aktivitet.

Shenim: Kjo kerkese permbushet nepermjet paraqitjes nga operatorët ekonomik të formularit permbledhes të vetedeklarimit sipas shtojcës perkatese të DST-se dhe dokumentacioni i kerkuar duhet të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar, i pari perpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe fillimit të afateve të ankimit”, pasi nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion provues që ka shlyer detyrimet për pagimin e taksave dhe tarifave vendore për operatorin ekonomik “REJ” SH.P.K i cili është njeri nga anetaret e Bashkimit të Operatoreve Ekonomike.

Komisioni i Vleresimit të Ofertave mban në konsideratë se për permbushjen e këtij kriteri operatorët ekonomike duhet të paraqesin dokument që vërteton se ka paguar të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore për të gjitha vendet ku operatori ushtron aktivitet dhe në rastin e Bashkimit të Operatoreve Ekonomike cdo anëtar duhet të paraqesë vertetimin përkatës.

Po ashtu, KVO mban në konsideratë se në nenin 26, të VKM-se 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, parashikohet se:

1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetedeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.

2. Formulari përmbledhës i vetedeklarimit përmban informacion dhe deklarin, si më poshtë vijon:

dh) operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e taksave dhe tatimeve 20të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 76, të LPP-së;

6. Në procedurat e prokurimit me një fazë, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i” dhe “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.

Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur pranë Bashkisë Lezhë rezulton se operatori ekonomik “REJ” SH.P.K i cili është pjesë e BOE-se nuk ka paraqitur vertetimin që ka shlyer detyrimet për taksat dhe tarifat vendore.

Sa më sipër duke qenë se njeri nga anetaret e Bashkimit të Operatoreve Ekonomik nuk ka paraqitur vertetimin që ka shlyer detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, ky kriter konsiderohet i papërmbushur.

Se katërti, nuk plotëson kriterin 2.3.1 të DST-se ku parashikohet se: “Operatoret Ekonomike duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme:

a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50 % e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës,

ose

b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

- Për kontrata të realizuara me autoritete publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

1. Formularin e vlerësimit;
2. Kontratën/Kontratat;
3. Situacionin përfundimtar;
4. Akt Kolaudimi
5. Faturat tatimore të deklaruara në organet tatimore;
6. Çertifikatën e marrjes në dorezim/ Çertifikatën e perhershme të marrjes në dorezim

-Për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

1. Kontratë sipermarrje;
2. Leje për kryerje punimesh
3. Situacionin përfundimtar;
4. Fatura tatimore të deklaruara në organet tatimore;
5. Çertifikatën e marrjes në dorezim/Çertifikatën e perhershme të marrjes në dorezim;

Pika 2.3.1/a plotësohet nga anëtarë i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Kurse pika 2.3.1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Shenim: Për punët e ngjashme të realizuara si BOE krahas dokumenteve të mesipërme duhet të paraqitet edhe kontrata e bashkepunimit ku përcaktohet ndarja e zerave të punimeve ndërmjet paleve, ndërsa për punët e ngjashme të realizuara si nenkontraktor duhet të paraqitet kontrata e nenkontraktimit ku përcaktohen zerat e punimeve si dhe miratimi i autoritetit kontraktor/investitorit.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave mban në konsideratë se për përmbushjen e këtij kriteri operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme të realizuar në sektorin publik apo privat për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50 % e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës ose punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet dhe në rastin e Bashkimit të Operatoreve Ekonomike cdo anëtar duhet të paraqesë dokumentacionin përkatës.

Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur pranë Bashkisë Lezhë rezulton se operatori ekonomik “REJ” SH.P.K i cili është pjesë e BOE-se nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion që provon realizimin e punëve të ngjashme sipas kërkesave të kriterit 2.3.1 të DST-se.

Sa me sipër duke qenë se njëri nga anëtarët e Bashkimit të Operatorëve Ekonomik nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion që provon realizimin e punëve të ngjashme, ky kriter konsiderohet i papërmbyshur.

Se pesti, nuk plotëson kriterin 2.3.5 të DST-se ku parashikohet se: “Krahas stafit teknik Operatorët Ekonomikë duhet të kenë të përfshirë staf mbështetës si më poshtë:

Teknik Ndërtimi	1 (një)	Diplome shkolle mesme
- Teknik Mekanik	1 (një)	Diplome shkolle mesme
- Teknik Elektrik	1 (një)	Diplome shkolle mesme
- Teknik Hidraulik	1 (një)	Diplome shkolle mesme
- Teknik Elektronik	1 (një)	Diplome shkolle mesme
- Teknik Gjeometër/Topograf , 1 (një)		Diplome shkolle mesme
- Elektrici	2 (dy)	Çertifikatë trajnimi/Deshmi Profesionale
- Hidraulik	2 (dy)	Çertifikatë trajnimi/Deshmi Profesionale
- Karpentier	2 (dy)	Çertifikatë trajnimi/Deshmi Profesionale
- Hekurkthyes	2 (dy)	Çertifikatë trajnimi/Deshmi Profesionale
- Betonues	2 (dy)	Çertifikatë trajnimi/Deshmi Profesionale
- Suvatues	2 (tre)	Çertifikatë trajnimi/Deshmi Profesionale
- Plakashtues	2 (dy)	Çertifikatë trajnimi/Deshmi Profesionale
- Bojaxhi	2 (dy)	Çertifikatë trajnimi/Deshmi Profesionale
- Hidroizolues	2 (një)	Çertifikatë trajnimi/Deshmi Profesionale
- Punonjës Gipsi	2 (dy)	Çertifikatë trajnimi/Deshmi Profesionale
- Saldator	1 (dy)	Çertifikatë trajnimi/Deshmi Profesionale
- Marangoz	1 (dy)	Çertifikatë trajnimi/Deshmi Profesionale
- Shofer	4 (kater)	Leje Drejtimi
- Manovrator	4 (kater)	Deshmi e Aftësisë Profesionale (DAP)

Operatori ekonomik duhet të paraqes për stafin e mesipër: Kontratat individuale të punës, Diplome Universitare/ Diplome e shkolle mesme/ Deshmite profesionale/ Deshmi e Aftësisë Profesionale (DAP)/ Leje Drejtimi sipas shënimeve për çdo kategori të mesipërme si dhe stafi i mesipërme të figurojë në listë pagesat e shoqërisë për periudhën Shkurt 2025 - Prill 2025.

V.O- Dokumentacioni (Diplomat/deshmite/certifikatat) që nuk janë leshuar sipas legjislacionit përkatës të arsimimit profesional do të konsiderohen jo të sakta dhe behen shkak për veprime të metëjshme sipas parashikimeve përkatëse të ligjit të prokurimit publik.

Për profesionet si më sipër, operatori ekonomik duhet të plotësojë tabelën si më poshtë:

Nr.	Emri Mbiemër i punonjësit	Profesioni i punonjësit në certifikatë/diplomë	Emri i Institucionit publik/privat leshues i certifikatës/diplomës	Numri i identifikues i certifikatës/diplomës	Nr NIPT - (Në rast se leshuesi është institucion privat)
-----	---------------------------	--	--	--	--

1					
2					
.....					

Shenim: Kjo kerkese permbushet nepermjet paraqitjes nga operatorët ekonomik të formularit permbledhes të vetedeklarimit sipas shtojcës perkatese të DST-se dhe tabelës së mesipërme, të cilat duhet të dorëzohen në fazën e ofertimit në SPE. Ndërsa dokumentacioni provues i kerkuar duhet të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar, i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraprak dhe fillimit të afatëve të ankimit.

KVO verën se bazuar në pikën 1 të nenit 26, të VKM-se nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parshikohet se: *Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si prove paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose pale të treta, formularin përmbledhës të vetedeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këtë rregullë, dhe për të përmbushur këto kriter operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të vetedeklarojnë në formularin përmbledhes të vetedeklarimit sipas shtojcës perkatese të DST-se, të dhënat e stafit mbështetës që disponon sipas përcaktimeve të pikës 2.3.5 të DST-se dhe përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatëve të ankimit, ofertuesi i kualifikuar, i pari duhet të dorëzojë dokumentet provuese (Kontratat individuale të punës, Diplome Universitare/ Diplome e shkolles mesme/ Dëshmi të profesionale/ Dëshmi të aftësive Profesionale (DAP)/ Leje Drejtimi sipas shënimeve për çdo kategori të mesipërme si dhe stafi i mesipërme të figurojë në listëpagesat e shoqërisë për periudhën Shkurt 2025 - Prill 2025)*

Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur pranë Bashkisë Lezhë, vërehet se operatori ekonomik “REJ” SH.P.K i cili është pjesë e BOE-se nuk ka paraqitur Formularin Përmbledhes të Vetedeklarimit dhe asnjë dokumentacion provues (Listëpagesa, kontratë pune diplome të shkolles së mesme, dëshmi të profesionale) për disponimin e 1 Teknik Mekanik, 1 Hidraulik, 2 Plakashtues, 2 Bojaxhi, 1 Hidroizolues, pasi nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion provues për disponimin e tyre.

Sa më sipër duke qenë se anëtari i BOE-se “REJ” SH.P.K nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion provues për disponimin e stafit mbështetës të sipër cituar, ky kriter konsiderohet i papërmbushur.

Se gjashti, nuk plotëson kriterin 2.3.10 të DST-se, ku parashikohet se: **“Operatori ekonomik në rast se nuk është prodhues duhet të paraqesë kontratë e furnizimit për materialet si më poshtë: 2.3.10/1 Për Bojrat dhe Gipsin**

- Kontratë paraprake furnizimi me prodhuesin ose distributorin e autorizuar. Në rast paraqitje kontratë furnizimi me distributorin zyrtar, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë autorizimin/aktin e marrëveshjes ose çdo dokument tjetër që provon lidhjen midis prodhuesit dhe distributorit zyrtar.

2.3.10/2 Për Materialet e termoizolimit, hidroizoluese dhe suvase:

- Kontrate paraprake furnizimi me prodhuesin ose distributorin e autorizuar. Në rast paraqitje kontrate furnizimi me distributorin zyrtar, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë autorizimin/aktin e marrëveshjes ose cdo dokument tjetër që provon lidhjen midis prodhuesit dhe distributorit zyrtar.

2.3.10/3 Per Materialet Elektrike:

- Kontrate paraprake furnizimi me prodhuesin ose distributorin e autorizuar. Në rast paraqitje kontrate furnizimi me distributorin zyrtar, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë autorizimin/aktin e marrëveshjes ose cdo dokument tjetër që provon lidhjen midis prodhuesit dhe distributorit zyrtar.

2.3.10/4 Per Materialet Hidraulike:

- Kontrate paraprake furnizimi me prodhuesin ose distributorin e autorizuar. Në rast paraqitje kontrate furnizimi me distributorin zyrtar, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë autorizimin/aktin e marrëveshjes ose cdo dokument tjetër që provon lidhjen midis prodhuesit dhe distributorit zyrtar.

2.3.10/5 Per Hekurin

- Kontrate paraprake furnizimi me prodhuesin ose distributorin e autorizuar. Në rast paraqitje kontrate furnizimi me distributorin zyrtar, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë autorizimin/aktin e marrëveshjes ose cdo dokument tjetër që provon lidhjen midis prodhuesit dhe distributorit zyrtar.

2.3.10/6 Per Pajisjet e Kondicionimit

- Kontrate paraprake furnizimi me prodhuesin ose distributorin e autorizuar. Në rast paraqitje kontrate furnizimi me distributorin zyrtar, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë autorizimin/aktin e marrëveshjes ose cdo dokument tjetër që provon lidhjen midis prodhuesit dhe distributorit zyrtar.

2.3.10/7 Per Ashensorin

- Kontrate paraprake furnizimi me prodhuesin ose distributorin e autorizuar. Në rast paraqitje kontrate furnizimi me distributorin zyrtar, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë autorizimin/aktin e marrëveshjes ose cdo dokument tjetër që provon lidhjen midis prodhuesit dhe distributorit zyrtar.

Nga analizimi i Dokumentave standarte te tenderit verëhet se per vendosjen e ketij kriteri Autoriteti Kontraktor është bazuar ne zerat e preventivit te punimeve qe do te realizohen dhe rendesise se vecante te objektit te prokurimit duke vleresuar si te nevojshme qe mallrat qe do te perdoren ne realizimin e punimeve te furnizohen nga prodhues apo distributor te autorizuar, kjo ne perputhje me kerkesat ligjore te parashikuara ne pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe ne nenin 39, pika 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”,

KVO verën se për përmbushjen e këtij kriteri OE-te në rast se **nuk janë prodhues** duhet të paraqesin, **kontrate paraprake furnizimi me prodhuesin ose distributorin e autorizuar**.

Në rast paraqitje kontrate furnizimi me distributorin zyrtar, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë autorizimin/ aktin e marrëveshjes ose cdo dokument tjetër që provon lidhjen midis prodhuesit dhe distributorit zyrtar.

Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur pranë Bashkisë Lezhë rezulton se BOE nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion që provon përmbushjen e këtij kriteri.

Se shtati, nuk plotëson kriterin 2.3.11 të DST-se ku parashikohet se: *“Operatori ekonomik duhet të dorëzojë katalog/fragment katalogu/ skedë teknike, për mallrat e mëposhtme:*

<i>Nr</i>	<i>Emertimi i Mallit</i>
1	Ashensori
2	Njesi e jashtme kondicionimi me kompresor inverter
3	Panel Diellore 300l
4	FV UPS 30kVA 3:3(3-fazor) me autonomi 10min

Katalogu/fragment katalogu/ skedë teknike duhet të markohet në mënyrë të qartë dhe të dallueshme secili nga artikujt e mesipër sipas modelit të deklaruar dhe të shenohen për të gjithë artikujt e mesipërme”.

Thëksojmë se për të përmbushur pikën 2.3.11, në lidhje me dorëzimin e katalog/fragment katalogu/ skedë teknike për mallrat e kërkuara, OE duhet të paraqesin në SPE Katalog/fragment katalogu/ skedë teknike dhe për secilin nga mallrat duhet të markohet në mënyrë të qartë dhe të dallueshme.

Nga verifikimi në SPE rezulton se nuk ka asnjë dokumentacion që provon përmbushjen e këtij kriteri.

Sa me sipër Komisioni i Vlerësimit të Ofertave mbështetur nën 77, pikë 1, 4 dhe 5, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës. 4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar

kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve, si dhe në nenin 92, pika 3 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet: “Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji”, vendosi të refuzojë ofertën e BOE “DESARET COMPANY” SH.P.K & “REJ” SH.P.K, për mos përmbushje të kriterëve të vecanta kualifikuese.

Si perfundim, në mbështetje të nenit 92, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, BOE “DESARET COMPANY” SH.P.K, ME NUIS K01816001J & “REJ” SH.P.K ME NUIS J93711608Q, skualifikohet.

IV-Operatori Ekonomik “DION-AL” SH.P.K, me Nuis K67917301H,

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

Nga verifikimi i dokumentacionit në SPE rezulton se OE ka dorezuar të gjithë dokumentacionin në përputhje me kriteret e përgjithshme dhe të vecanta të kualifikimit të përcaktuar në dokumentat standarte të tenderit.

Komisioni i vlerësimit të ofertave mbështetur në nenin 92, pika 3, ligjit nr.162/2020, “Për prokurimin publik”, ku parashikohet shprehimisht se: Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji.

Oferta konsiderohet e vlefshme edhe nëse ajo përmban devijime të vogla, të cilat nuk ndryshojnë thelbësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, gabime shtypi, të cilat mund të korrigjohen pa prekur përmbajtjen e saj, si edhe ato të lidhura me informacionet që merren lehtësisht nga dokumente faktike, që tregojnë gjendjen e operatorit ekonomik në kohën e ofertimit.

Per sa me siper oferta e dorezuar në SPE nga OE “DION-AL” SH.P.K, me Nuis K67917301H, është kualifikuar.

Me datë 09/07/2025, bazuar dhe në klasifikimin paraprak të ofertave me anë të Sistemit të Prokurimit Publik, i ka kërkuar Operatorit Ekonomik “DION-AL” SH.P.K, me Nuis K67917301H, i klasifikuar i pari, dorezimin e dokumentacionit origjinal ose fotokopje të noterizuar të dokumentave të tenderit pranë zyres së protokollit të Bashkisë Lezhe brenda datës 14/07/2025.

Ne vijim me date 15/07/2025, Komisioni i Vleresimit te Ofertave u mblodh per te bere vleresimin e dokumentacionit qe duhet te paraqitet fizikisht prane Bashkise Lezhe nga Operatori Ekonomik i klasifikuar i pari duke mbajtur ne konsiderate se:

Ne daten 09/07/2025 jane klasifikuar paraprakisht te kualifikuar ne vleresimin e dokumentacionit te paraqitur ne SPE operatoret ekonomike te meposhtem:

1. Operatori Ekonomik "DION-AL" SH.P.K, me Nuis K67917301H,
2. Operatori Ekonomik "ASI-2A CO" SH.P.K, me NUIS K53002402C,
3. Operatori Ekonomik "LLAZO" SH.P.K, me NUIS K24218401K,
4. Operatori Ekonomik "ERGI" SH.P.K, me NUIS K02727229P,

Per rrjedhoje Komisioni I vleresimit te ofertave bazuar ne piken 1 dhe 5, te nenit 82, te Ligjit Nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik", ku parashikohet se:

1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik. Kur autoriteti ose enti kontraktor mund t'i marrë dokumentet mbështetëse duke u futur direkt në një bazë të aksesueshme të dhënash shtetërore, në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit përcaktohet edhe informacioni që kërkohet për këtë qëllim, siç është adresa në internet e bazës të të dhënave, çdo e dhënë identifikimi dhe, sipas rastit, në deklaratën e nevojshme për dhënien e pëlqimit. Operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.

5. Në çdo rast, përpara se të japë kontratën, autoriteti ose enti kontraktor duhet t'i kërkojë ofertuesit fitues që të dorëzojë:

- a) dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike, të cilat në kohën e dorëzimit pranë autoritetit kontraktor duhet të jenë në origjinal ose kopje të noterizuara të tyre;*
- b) dokumentet mbështetëse në origjinal ose një kopje të noterizuar të tyre për vetëdeklarimet e dhëna.*

dhe bazuar piken 1, 6 dhe 7 te nenit 26, te VKM-së Nr. 285, datë 19.5.2021 "Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar, ku parashikohet se:

1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.

6. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat "a", "b", "d", "dh", "e", "h", "i", "j" të pikës 2 të këtij neni, si dhe

dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin.

Autoriteti/enti kontraktor pranon një dokument të lëshuar nga i njëjti institucion ose palë e tretë dhe që ka të njëjtin informacion me atë të paraqitur në procedurën e zhvilluar në mënyrë elektronike.

Operatorët ekonomikë të huaj duhet të paraqesin dokumentet në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit të lëshuar në një shtet të huaj.

Për dokumentet që nuk lëshohen në vendin e origjinës, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë këtë fakt, përndryshe dokumentacioni do të konsiderohet i paparaqitur.

7. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

...me date 09/07/2025, bazuar dhe në klasifikimin paraprak të ofertave me anë të Sistemit të Prokurimit Publik, i ka kërkuar Operatorit Ekonomik “DION-AL” SH.P.K, me Nuis K67917301H, i klasifikuar i pari, dorëzimin e dokumentacionit origjinal ose fotokopje të noterizuar të dokumentave të tenderit pranë zyres së protokollit të Bashkisë Lezhë brenda datës 14/07/2025.

Theksojme se nga shqyrtimi i dokumentacionit të procedurës së prokurimit konstatohet se me procesverbalin Nr. 02, datë 09/07/2025 për vlerësimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit me objekt: “Rikonstruksioni i shkollës 9-vjeçare “Gjergj Fishta”, Lezhë”, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave ka kualifikuar Operatorin Ekonomik “DION-AL” SH.P.K, me Nuis K67917301H dhe me datën 09.07.2025, i ka kërkuar me anë të sistemit të Prokurimeve Elektronike dorëzimin e dokumentacionit fizik origjinal ose kopje të njehesuar me origjinalin sipas parashikimit në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j”, të pikës 2, të nenit 26, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2022 “Për miratimin e rregulave të prokurimit publik”, të ndryshuar, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.

Komisioni i vlerësimit të Ofertave, verifikoi në zyrën e protokoll-arkives regjistrat e shkresave hyres ku nga verifikimi rezultoi se Operatori Ekonomik “DION-AL” SH.P.K, me Nuis K67917301H nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion apo shkresë pranë Bashkisë Lezhë nga data e kërkesës së Autoritetit Kontraktor në SPE deri në datën 14.07.2025 dhe më tej as deri në datën e vlerësimit të dokumentacionit. Gjithashtu KVO thekson se as në protokollin e Bashkisë Lezhë apo në Sistemin e Prokurimeve Elektronikë ky OE nuk ka paraqitur asnjë shkresë apo kërkesë për shtyrje të afatit të dorëzimit të dokumentave.

Theksojme se në nenin 26, pika 6, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2022 “Për miratimin e rregulave të prokurimit publik” të ndryshuar, parashikohet se “**Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”,**

“i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.

Autoriteti/enti kontraktor pranon një dokument të lëshuar nga i njëjti institucion ose palë e tretë dhe që ka të njëjtin informacion me atë të paraqitur në procedurën e zhvilluar në mënyrë elektronike.

Operatorët ekonomikë të huaj duhet të paraqesin dokumentet në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit të lëshuar në një shtet të huaj.

Për dokumentet që nuk lëshohen në vendin e origjinës, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë këtë fakt, përndryshe dokumentacioni do të konsiderohet i paparaqitur”.

Komisioni i Vleresimit të Ofertave thekson se cdo operator ekonomik i cili kualifikohet paraprakisht pas vleresimit të dokumentacionit në SPE, ka detyrimin ligjor të paraqitjes fizikisht prane Autoritetit Kontraktor të gjithë dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j”, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike në përputhje me nenin 26, të VKM-se nr. 285, datë 19.05.2022 “Për miratimin e rregulave të prokurimit publik”, të ndryshuar.

Per sa me lart, Komisioni i Vleresimit të Ofertave konstaton se Operatori Ekonomik “DION-AL” SH.P.K, me Nuis K67917301H nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion fizik origjinal apo kopje të njehesuar me origjinalin duke mos përmbushur asnjë nga kriteret e parashikuara në DST.

Sa me sipër Komisioni i Vleresimit të Ofertave mbështetur në nenin 77, pika 1, 4 dhe 5, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës. 4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës. 5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve, si dhe në nenin 92, pika 3 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet: “Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat

dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji”, vendosi te refuzojë ofertën e OE “DION-AL” SH.P.K, me Nuis K67917301H, për mos përmbushje të kriterëve të vecanta kualifikuese.

Si perfundim, në mbështetje të nenit 92, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, OE “DION-AL” SH.P.K, me Nuis K67917301H, skualifikohet.

V- Operatori Ekonomik “Eduart Çela” P/F me NUIS M03806202I

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik rezulton se nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion në SPE dhe për rrjedhojë nuk plotëson asnjë nga kriteret e përgjithshme dhe të vecanta të kualifikimit.

Sa me sipër Komisioni i Vlerësimit të Ofertave mbështetur nënën 77, pika 1, 4 dhe 5, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës. 4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës. 5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve, si dhe në nënën 92, pika 3 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet: “Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji”, vendosi te refuzojë ofertën e OE “Eduart Çela” P/F, për mos përmbushje të kriterëve të vecanta kualifikuese.

Si perfundim, në mbështetje të nenit 92, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, OE “Eduart Çela” P/F me NUIS M03806202I, skualifikohet.

VI- Operatori Ekonomik “INA” SH.P.K, me NUIS J61814009W,

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

Nga verifikimi i dokumentacionit ne SPE rezulton se OE ka dorezuar te gjithë dokumentacionin ne perputhje me kriteret e pergjithshme dhe te vecanta te kualifikimit te percaktuar ne dokumentat standarte te tenderit.

Komisioni i vleresimit te ofertave mbeshetur në nenin 92, pika 3, ligjit nr.162/2020, “Për prokurimin publik”, ku parashikohet shprehimisht se: Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji.

Oferta konsiderohet e vlefshme edhe nëse ajo përmban devijime të vogla, të cilat nuk ndryshojnë thelbësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, gabime shtypi, të cilat mund të korrigjohen pa prekur përmbajtjen e saj, si edhe ato të lidhura me informacionet që merren lehtësisht nga dokumente faktike, që tregojnë gjendjen e operatorit ekonomik në kohën e ofertimit.

Per sa me siper oferta e dorezuar nga OE “INA” SH.P.K me NUIS J61814009W, eshte kualifikuar.

Ne vijim, Komisioni i Vleresimit te Ofertave pas kualifikimit te 6 ofertave te vlefshme bazuar ne ligjin nr. 16/2024 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 162/2020“Për prokurimin publik”, ne nenin 27, ku percaktohet se: *“Në nenin 93 pas pikës 4 shtohet pika 5 me këtë përmbajtje: “5. Në procedurat e prokurimit me vlerë nën kufijtë e lartë monetarë, autoritetet ose entet kontraktore refuzojnë pa kërkuar shpjegime një ofertë, e cila është konstatuar anomalisht e ulët”, si dhe nenin 82/4, te VKM-se nr. 285, date 19.05.2021 “Per miratimin e rregullave te prokurimit publik”, i ndryshuar, ku parashikohet se “Pas korrigjimit të gabimeve aritmetike, komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon nëse ofertat e vlefshme janë ose jo me çmim anomalisht të ulët sipas formulës së përcaktuar në dokumentet standarde të tenderit. Përlllogaritja e ofertës anomalisht të ulët bëhet në mënyrat e mëposhtme:*

- *Në rastin kur janë të vlefshme dy ose më pak oferta, në përputhje me nenin 93, të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët kur ajo është ulur më shumë se 25% e fondit limit të përlllogaritur;*
- *Në rastin kur janë të vlefshme tri ose më shumë oferta, në përputhje me nenin 93, të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët nëse vlera e saj do të jetë më e vogël se 85% e mesatares së ofertave të vlefshme.*

verifikoi 6 ofertat e kualifikuara te vlefshme nëse janë ose jo me çmim anomalisht të ulët sipas formulës së përcaktuar në dokumentet standarde të tenderit ku rezultoi se vlera mesatare e 6

ofertave te paraqitura eshte 137,280,429.07 ndersa **85% e mesatares së ofertave të vlefshme** eshte $137,280,429.07 \times 85\% = 116,688,364.71$

Komisioni i Vleresimit te Ofertave krahasoi vlerat e 6 ofertave te vlefshme me vleren e 85% te mesatares se tyre ku rezultoi se nga krahasimi i ketyre ofertave vetem oferta e paraqitur nga Operatori Ekonomik “INA” SH.P.K prej 108,297,388 (njëqind e tetë milion e dyqind e nëntëdhjetë e shtatë mijë e treqind e tetëdhjetë e tetë) Lek pa TVSH **eshte anomalisht e ulet**, bazuar kjo ne nenin 27, te ligjin nr. 16/2024 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 162/2020“Për prokurimin publik”, si dhe nenin 82/4, te VKM-se nr. 285, date 19.05.2021 “Per miratimin e rregullave te prokurimit publik” i ndryshuar.

Komisioni i Vleresimit te Ofertave thekson se oferta e paraqitur nga OE “INA” SH.P.K eshte oferte papergjegjshme dhe rezulton ne te gjitha rastet anaomalisht e ulet.

KVO konstaton se oferta ekonomike e paraqitur nga “INA” SH.P.K eshte 30% me e ulet se fondi limit te perlllogaritur qe rezulton anomalisht e ulet dhe po ashtu oferta e OE “INA” SH.P.K rezulton me vlere rreth 78% e mesatares se ofertave te kualifikuara dhe per rrjedhoje edhe ne kete rast eshte anomalisht e ulet.

Per sa me lart Komisioni I Vleresimit te Ofertave bazuar ne nenin 27, te ligjit nr. 16/2024 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 162/2020“Për prokurimin publik” ku parashikohet se autoritetet ose entet kontraktore **refuzojnë pa kërkuar shpjegime një ofertë**, e cila është konstatuar anomalisht e ulët, vendosi refuzimin e ofertes se Operatorit Ekonomik “INA” SH.P.K.

Sa me siper Komisioni i Vleresimit te Ofertave mbeshetur nenin 77, pika 1, 4 dhe 5, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës. 4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës. 5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve, si dhe ne në nenin 92, pika 3 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet: “Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të

këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji”, vendosi të refuzojë ofertën e OE “INA” SH.P.K “, për mos përmbushje të kriterëve të vecanta kualifikuese.

Si perfundim, në mbështetje të nenit 92, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, OE “INA” SH.P.K me NUIS J61814009W, skualifikohet.

VII- OPERATORI EKONOMIK “JUNIK” SH.P.K ME NUIS J68007522L

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

Nga verifikimi i dokumentacionit në SPE rezulton se:

Se pari, nuk ka deklaruar ortakun në formularin përmbledhës të vetedeklarimit nëse personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose që ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, nuk është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së.

“KVO verën se bazuar në pikën 1 dhe 2 (c), të nenit 26, të VKM-se nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parshikohet se:

1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetedeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla,

2. formulari përmbledhës i vetedeklarimit përmban informacion dhe deklarin, si më poshtë vijon:

c) personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose që ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, nuk është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;

, për të përmbushur këto kritere duhet të paraqitet Formulari Përmbledhës i Vetedeklarimit të operatoreve ekonomike në ditën e hapjes së Ofertës, me të dhënat për personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose që ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik.

Nga verifikimi i dokumentacionit rezulton se Operatori Ekonomik nuk ka plotësuar të dhënat për ortakun, në seksionin në lidhje me informacionin dhe deklarin në zbatim të pikës 2(c) të nenit 26, të VKM-se nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, në të cilën duhet të deklarohet si më poshtë:

c) personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose që ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, nuk është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së”

Sa me sipër duke qenë se operatori ekonomike, nuk ka deklaruar në shtojcën 8, emrin e ortakut, ky kriter konsiderohet i papërbushur.

Se dyti, nuk plotëson kriterin 2.3.5 të DST-se, ku parashikohet se: “Krahas stafit teknik Operatorët Ekonomikë duhet të kenë të punësuar staf mbështetës si më poshtë:

Teknik Ndertimi	1 (nje)	Diplome shkolles mesme
- Teknik Mekanik	1 (nje)	Diplome shkolles mesme
- Teknik Elektrik	1 (nje)	Diplome shkolles mesme
- Teknik Hidraulik	1 (nje)	Diplome shkolles mesme
- Teknik Elektronik	1 (nje)	Diplome shkolles mesme
- Teknik Gjeometër/Topograf ,	1 (nje)	Diplome shkolles mesme
- Elektrici	2 (dy)	Çertifikate trajnimi/Deshmi Profesionale
- Hidraulik	2 (dy)	Çertifikate trajnimi/Deshmi Profesionale
- Karpertier	2 (dy)	Çertifikate trajnimi/Deshmi Profesionale
- Hekurkthyes	2 (dy)	Çertifikate trajnimi/Deshmi Profesionale
- Betonues	2 (dy)	Çertifikate trajnimi/Deshmi Profesionale
- Suvatues	2 (tre)	Çertifikate trajnimi/Deshmi Profesionale
- Plakashtues	2 (dy)	Çertifikate trajnimi/Deshmi Profesionale
- Bojaxhi	2 (dy)	Çertifikate trajnimi/Deshmi Profesionale
- Hidroizolues	2 (nje)	Çertifikate trajnimi/Deshmi Profesionale
- Punonjës Gipsi	2 (dy)	Çertifikate trajnimi/Deshmi Profesionale
- Saldator	1 (dy)	Çertifikate trajnimi/Deshmi Profesionale
- Marangoz	1 (dy)	Çertifikate trajnimi/Deshmi Profesionale
- Shofer	4 (kater)	Leje Drejtimi
- Manovrator	4 (kater)	Deshmi e Aftësisë Profesionale (DAP)

Operatori ekonomik duhet të paraqes për stafin e mesipër: Kontratat individuale të punës, Diplome Universitare/ Diplome e shkolles mesme/ Deshmi të profesionale/ Deshmi e Aftësisë Profesionale (DAP)/ Leje Drejtimi sipas shënimeve për çdo kategori të mesipërme si dhe stafi i mesipërme të figurojë në listëpagesat e shoqërisë për periudhën Shkurt 2025 - Prill 2025.

V.O- Dokumentacioni (Diplomat/deshmi/certifikatat) që nuk janë leshuar sipas legjislacionit përkatës të arsimimit profesional do të konsiderohen jo të sakta dhe behen shkak për veprime të metejshme sipas parashikimeve përkatëse të ligjit të prokurimit publik.

Për profesionet si më sipër, operatori ekonomik duhet të plotësojë tabelën si më poshtë:

Nr.	Emer Mbiemer i punonjesit	Profesioni i punojësit ne certifikate/diplome	Emri i Institucioni publik/privat leshues i certifikates/diplomes	Numri indetifikues i certifikates/diplomes	Nr NIPT - (Ne rast se leshuesi eshte institucion privat)
1					
2					
.....					

Shenim: Kjo kerkese permbushet nepermjet paraqitjes nga operatorët ekonomik te formularit permbledhes te vetedeklarimit sipas shtojces perkatese te DST-se dhe tabelës se mesiperme, te cilat duhet te dorezohen ne fazën e ofertimit ne SPE. Ndersa dokumentacioni provues i kerkuar duhet te paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar, i pari perpara publikimit te njoftimit te fituesit paraprak dhe fillimit te afateve te ankimit.

KVO verën se bazuar ne piken 1 te nenit 26, te VKM-se nr. 285 date 19.05.2021 “Per miratimin e rregullave te prokurimit publik”, i ndryshuar, parshikohet se: *Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si prove paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose pale te treta, formularin përmbledhës të vetedeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla, dhe për te permbushur kete kriter operatorët ekonomik pjesmarres duhet te vetedeklarojne ne formularin permbledhes te vetedeklarimit sipas shtojces perkatese te DST-se, te dhenat e stafit mbeshtetes qe disponon sipas percaktimeve te pikes 2.3.5 te DST-se.*

Nga verifikimi i dokumentacionit te paraqitur ne SPE, verehet se operatori ekonomik nuk disponon Teknikun Elektronik, pasi për plotesimin e ketij kriteri ka deklaruar punonjesin Z. Andi Gjini, me profesion Inxhinier Elektrik te punësuar ne rolin e nje tekniku elektronik.

Gjithashtu për plotesimin e ketij kriteri OE ka deklaruar punonjesen Ornela Zefi, me profesion Inxhinier Elektronik, te punësuar ne rolin e teknikut elektronik, ku ne te njejtën kohe po ky punonjes eshte deklaruar për pëmbushjen e kriterit 2.3.4 te Dst, ne lidhje me disponueshmerine e Drejtuesit Teknik ne fushën Elektronike ne Licensën e kompanisë.

Sa me sipër ky kriter konsiderohet I pa përmbushur pasi ne kriteret e vecanta te kualifikimit kerkohet qe krahas stafit kryesor teknik te drejtuesve teknik ne licensën e shoqërisë, Operatorët Ekonomik duhet te disponojne edhe staf mbeshtetes ne rolin e teknikut elektronik.

Sa me sipër duke qene se OE nuk ka deklaruar ne formularin përmbledhes te vetedeklarimit diponimin e nje Teknik elektronik, ky kriter konsiderohet i papermbushur.

Se dyti, nuk ploteson kriterin 2.3.7, te kushteve te veçanta te kualifikimit, ku parashikohet se: Operatorët Ekonomike duhet te dispojnë mjetet e meposhtme:

Nr	Lloji i makinerive	Pronësia	Njësi	Sasi
			a	a

1	Kamion veteshkarkues me kapacitet mbajtes min 10 ton	Ne pronesi, qira ose kontrate bashkepunimi	Cope	3
2	Kamion me Vinc	Ne pronesi, qira ose kontrate bashkepunimi	Cope	1
3	Autovinç me Kosh	Ne pronesi, qira ose kontrate bashkepunimi	Cope	1
4	Kamionçina me kapacitet mbajttese min 6 ton	Ne pronesi, qira ose kontrate bashkepunimi	Cope	2
5	Autobetoniere	Ne pronesi, qira ose kontrate bashkepunimi	Cope	1
6	Autopompe betoni	Ne pronesi, qira ose kontrate bashkepunimi	Cope	1
7	Eskavator me goma (mjet teknologjik me goma)	Ne pronesi, qira ose kontrate bashkepunimi	Cope	1
8	Fadrome me goma (mjet teknologjik me goma)	Ne pronesi, qira ose kontrate bashkepunimi	Cope	1
9	Skeleri dhe rrjete rrethimi	Ne pronesi, qira ose kontrate bashkepunimi	m2	1500
10	Saldatriçe	Ne pronesi, qira ose kontrate bashkepunimi	Cope	1
11	Matrapik dore	Ne pronesi, qira ose kontrate bashkepunimi	Cope	4
12	Vibrator	Ne pronesi, qira ose kontrate bashkepunimi	Cope	2
13	Betoniere kantieri	Ne pronesi, qira ose kontrate bashkepunimi	Cope	2
14	Pompe Suvatimi	Ne pronesi, qira ose kontrate bashkepunimi	Cope	2

Per te deshmuar kete, Formulari i shtojces te DST duhet te shoqerohet me dokumentat e meposhtme:

- Për mjetet që shënohen në regjistra publikë, kur jane ne pronesi, duhet të paraqitet dokumentacioni që vertetojne pronesine e mjetit: - certifikaten e pronesise; -leja e qarkullimit; -certifikaten e kontrollit teknik; - siguracionin; - taksat vjetore- leja e transportit, si dhe të paraqesë foto të qarte për secilin mjet dhe te jetë e dukshme targa e mjetit.
- Ndersa per mjete te marra me qera/kontrate bashkepunimi krahas dokumentacionit te mesiperm, duhet te paraqitet edhe kontrata e qerases/ bashkëpunimit.
- Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publikë, kur jane ne pronesi, duhet të paraqitet kontrata e blerjes apo çdoganimit, fotot dhe fatura tatimore perkatese, ndersa per mjete te marra me qera/ Kontrate bashkëpunimi, krahas dokumentacionit te mesiperm, duhet te paraqitet edhe kontrata e qeras/ Kontrate Bashkepunimi.

Shenim: Kjo kerkese permbushet nepermjet paraqitjes nga operatoret ekonomik te formularit permbledhes te vetedeklarimit sipas shtojces perkatese te DST-se dhe dokumentacioni i kerkuar duhet te paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar, i pari perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe fillimit te afateve te ankimimit.

KVO veren se bazuar ne piken 1 te nenit 26, te VKM-se nr. 285 date 19.05.2021 “Per miratimin e rregullave te prokurimit publik”, i ndryshuar, parshikohet se: *Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si prove paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose pale te treta, formularin përmbledhës të vetedeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla, dhe per te permbushur kete kriter operatoret ekonomik pjesmarres duhet te vetedeklarojne ne formularin permbledhes te vetedeklarimit sipas shtojces perkatese te DST-se, te dhenat e mjeteve qe disponon sipas percaktimeve te pikes 2.3.7 te DST-se.*

Nga verifikimi i dokumentacionit te paraqitur ne SPE, verehet se operatori ekonomik nuk disponon Autovic me kosh, pasi ka deklaruar se disponon ne pronesi me ane te nje fature.

Theksojme se Autovic me kosh eshte mjet me goma dhe regjistrohet prane DPTRRSH-se dhe pajiset me dokument pronesie dhe targa dhe per rrjedhoje ky OE nuk disponon nje autovinc me kosh ose nuk disponon dokumentacion te rregullt ligjor per levizjen e ketij mjeti (çertifikaten e pronesise; -leja e qarkullimit; -çertifikaten e kontrollit teknik; - siguracionin; - taksat vjetore- leja e transportit).

Sa me siper, ky kriter konsiderohet i papermbushur.

Se treti, nuk ploteson kriterin 2.3.10/4 te DST-se ku parashikohet se: **“Operatori ekonomik ne rast se nuk eshte prodhues duhet te paraqese kontrat e furnizimit per materialet si me poshte: 2.3.10/4 Per Materialet Hidraulike:**

- Kontrate paraprake furnizimi me prodhuesin ose distributorin e autorizuar. Në rast paraqitje kontrate furnizimi me distributorin zyrtar, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë autorizimin/aktin e marrëveshjes ose cdo dokument tjetër që provon lidhjen midis prodhuesit dhe distributorit zyrtar”.

Nga analizimi i Dokumentave standarte te tenderit verehet se per vendosjen e ketij kriteri Autoriteti Kontraktor eshte bazuar ne zerat e preventivit te punimeve qe do te realizohen dhe rendese se vecante te objektit te prokurimit duke vleresuar si te nevojshme qe mallrat qe do te perdoren ne realizimin e punimeve te furnizohen nga prodhues apo distributor te autorizuar, kjo ne perputhje me kerkesat ligjore te parashikuara ne pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe ne nenin 39, pika 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”,

Sa analizuam me siper dhe pas shqyrtimit te kriterit dhe qellimit te vendosjes se tij nga ana e Autoritetit Kontraktor, KVO veren se per permbushjen e ketij kriteri OE-te ne rast se **nuk jane**

prodhues duhet të paraqesin për “**Materialet hidraulike**”, kontratë paraprake furnizimi me prodhuesin ose distributorin e autorizuar.

Në rast paraqitje kontratë furnizimi me distributorin zyrtar, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë autorizimin/ aktin e marrëveshjes ose çdo dokument tjetër që provon lidhjen midis prodhuesit dhe distributorit zyrtar. Për Dokumentacionin në gjuhë të huaj Operatorët ekonomikë duhet të përkthejnë këtë dokumentacion në gjuhën shqipe.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave verifikon se për përmbushjen e këtij kriteri operatorët ekonomikë duhet të paraqesin për secilin nga materialet e kërkuar: Kontratë paraprake furnizimi me prodhuesin ose distributorin e autorizuar. Në rast paraqitje kontratë furnizimi me distributorin zyrtar, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë autorizimin/aktin e marrëveshjes ose çdo dokument tjetër që provon lidhjen midis prodhuesit dhe distributorit zyrtar.

Nga verifikimi në SPE rezulton se për **materialet e hidraulike**, OE ka paraqitur kontratë furnizimi me operator (furnizues) i cili nuk është prodhues.

Po ashtu nga verifikimi në SPE, vërehet se bashkëngjitur kontratës së furnizimit, OE ka paraqitur dokument në gjuhën angleze dhe italiane, të përkthyer në gjuhën shqipe, të cilin e ka paraqitur si autorizim.

KVO verifikon se në pikën 2, të nenit 24, të VKM-së 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, parashikohet se:

2. Në rastin e procedurave të prokurimit mbi kufijtë e lartë monetarë, dokumentet e tenderit duhet të hartohen në gjuhët shqip dhe anglisht. Operatorët ekonomikë mund të paraqesin ofertat e tyre në gjuhët shqip ose anglisht. Në procedurat e prokurimit nën kufijtë e lartë monetarë, gjuha e përdorur është gjuha shqipe. Në këtë procedurë, në raste specifike, nëse autoriteti/enti kontraktor e gjykon të nevojshme, mund të hartojë dokumentet e tenderit në gjuhët shqip dhe anglisht dhe njofton operatorët ekonomikë se mund të paraqesin ofertat e tyre në gjuhët shqip ose anglisht.

Gjithashtu, Komisioni i Prokurimit Publik në vendimin nr. 825/2021, mban të njëjtin qëndrim në të cilin theksohet se: **“II.4.4. Komisioni i Prokurimit Publik, referuar përcaktimeve ligjore mbi përdorimi e gjuhës shqipe në dokumentet e tenderit, për të qenë sa më të kuptueshme për palët dhe për të krahasuar përputhshmërinë e parametrave dhe të dhënave të mallit që prokurohet, është e nevojshme që për artikujt, objekt-prokurimi, të dhënat e katalogut të jenë të përkthyer në gjuhën shqipe, gjuhë e përdorur në dokumentet e procedurës së prokurimit. Në këtë kuptim KPP gjykon, se autoriteti kontraktor ka hartuar kriterin në përputhje me dispozitat ligjore dhe kriteri nuk le vend për konfuzion”.**

Sa me sipër duke qenë se furnizuesi i paraqitur nga BOE për materialet e mesiperme nuk është prodhues, si dhe autorizimi i prodhuesit është i përkthyer në gjuhën shqipe ky kriter konsiderohet i përmbushur.

Se katerti, nuk ploteson kriterin 2.3.10/6 të DST-se ku parashikohet se: “Operatori ekonomik në rast se nuk është prodhues duhet të paraqesë kontratë e furnizimit për materialet si më poshtë:

2.3.10/6 Per Pajisjet e Kondicionimit

- Kontrate paraprake furnizimi me prodhuesin ose distributorin e autorizuar. Në rast paraqitje kontrate furnizimi me distributorin zyrtar, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë autorizimin/aktin e marrëveshjes ose cdo dokument tjetër që provon lidhjen midis prodhuesit dhe distributorit zyrtar”.

Nga analizimi i Dokumentave standarte të tenderit verëhet se për vendosjen e këtij kriteri Autoriteti Kontraktor është bazuar në zërat e preventivit të punimeve që do të realizohen dhe rendesise të vecante të objektit të prokurimit duke vlerësuar si të nevojshme që mallrat që do të perdoren në realizimin e punimeve të furnizohen nga prodhues apo distributor të autorizuar, kjo në përputhje me kërkesat ligjore të parashikuara në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe në nenin 39, pikë 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”,

Sa analizuam me sipër dhe pas shqyrtimit të kriterit dhe qëllimit të vendosjes së tij nga ana e Autoritetit Kontraktor, KVO verën se për përmbushjen e këtij kriteri OE-të në rast se ***nuk janë prodhues*** duhet të paraqesin për ***“Pajisjet e Kondicionimit”, kontratë paraprake furnizimi me prodhuesin ose distributorin e autorizuar.***

Në rast paraqitje kontrate furnizimi me distributorin zyrtar, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë autorizimin/ aktin e marrëveshjes ose cdo dokument tjetër që provon lidhjen midis prodhuesit dhe distributorit zyrtar. Për Dokumentacionin në gjuhë të huaj Operatorët ekonomikë duhet të përkthejnë këtë dokumentacion në gjuhën shqipe.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave verën se për përmbushjen e këtij kriteri operatorët ekonomikë duhet të paraqesin për secilin nga materialet e kërkuar: Kontrate paraprake furnizimi me prodhuesin ose distributorin e autorizuar. Në rast paraqitje kontrate furnizimi me distributorin zyrtar, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë autorizimin/aktin e marrëveshjes ose cdo dokument tjetër që provon lidhjen midis prodhuesit dhe distributorit zyrtar.

Nga verifikimi në SPE rezulton se për ***pajisjet e kondicionimit***, OE ka paraqitur kontratë furnizimi me operator (furnizues) i cili nuk është prodhues.

Po ashtu nga verifikimi në SPE, verëhet se bashkëngjitur kontratës së furnizimit, OE ka paraqitur dokument në gjuhën angleze dhe italiane, të përkthyer në gjuhën shqipe, të cilin e ka paraqitur si autorizim.

KVO verën se në pikën 2, të nenit 24, të VKM-së 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, parashikohet se:

2. Në rastin e procedurave të prokurimit mbi kufijtë e lartë monetarë, dokumentet e tenderit duhet të hartohen në gjuhët shqip dhe anglisht. Operatorët ekonomikë mund të paraqesin ofertat e tyre

në gjuhët shqip ose anglisht. Në procedurat e prokurimit nën kufijtë e lartë monetarë, gjuha e përdorur është gjuha shqipe. Në këto procedura, në raste specifike, nëse autoriteti/enti kontraktor e gjykon të nevojshme, mund të hartojë dokumentet e tenderit në gjuhët shqip dhe anglisht dhe njofton operatorët ekonomikë se mund të paraqesin ofertat e tyre në gjuhët shqip ose anglisht.

Gjithashtu, Komisioni i Prokurimit Publik në vendimin nr. 825/2021, mban te njejtin qëndrim në të cilin theksohet se: ***“II.4.4. Komisioni i Prokurimit Publik, referuar përcaktimeve ligjore mbi përdorimi e gjuhës shqipe në dokumentet e tenderit, për të qenë sa më të kuptueshme për palët dhe për të krahasuar përputhshmërinë e parametrave dhe të dhënave të mallit që prokurohet, është e nevojshme që për artikujt, objekt-prokurimi, të dhënat e katalogut të jenë të përkthyer në gjuhën shqipe, gjuhë e përdorur në dokumentet e procedurës së prokurimit. Në këtë kuptim KPP gjykon, se autoriteti kontraktor ka hartuar kriterin në përputhje me dispozitat ligjore dhe kriteri nuk le vend për konfuzion”.***

Sa me sipër duke qenë se furnizuesi i paraqitur nga BOE për materialet e mesiperme nuk është prodhues, si dhe autorizimi i prodhuesit është i papërkthyer në gjuhën shqipe ky kriter konsiderohet i papërmbyshur.

Sa me sipër Komisioni i Vlerësimit të Ofertave mbështetur në nenin 77, pikë 1, 4 dhe 5, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës. 4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës. 5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve, si dhe në nenin 92, pikë 3 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet: “Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji”, vendosi të refuzojë ofertën e OE “JUNIK” SH.P.K, për mos përmbushje të kriterëve të vecanta kualifikuese.

Si perfundim, në mbështetje të nenit 92, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, OE “JUNIK” SH.P.K ME NUIS J68007522L, skualifikohet.

VIII- Operatori Ekonomik “NDREGJONI” SH.P.K me NUIS K31329048I

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

Nga verifikimi i dokumentacionit ne SPE rezulton se OE:

Se pari, nuk ploteson kriterin 2.3.5 të DST-se ku parashikohet se: “Krahas stafit teknik Operatoret Ekonomike duhet të kenë të punësuar staf mbështetës si më poshtë:

<i>Teknik Ndertimi</i>	<i>1 (nje)</i>	<i>Diplome shkolles mesme</i>
- <i>Teknik Mekanik</i>	<i>1 (nje)</i>	<i>Diplome shkolles mesme</i>
- <i>Teknik Elektrik</i>	<i>1 (nje)</i>	<i>Diplome shkolles mesme</i>
- <i>Teknik Hidraulik</i>	<i>1 (nje)</i>	<i>Diplome shkolles mesme</i>
- <i>Teknik Elektronik</i>	<i>1 (nje)</i>	<i>Diplome shkolles mesme</i>
- <i>Teknik Gjeometer/Topograf , 1 (nje)</i>		<i>Diplome shkolles mesme</i>
- <i>Elektracist</i>	<i>2 (dy)</i>	<i>Çertifikate trajnimi/Deshmi Profesionale</i>
- <i>Hidraulik</i>	<i>2 (dy)</i>	<i>Çertifikate trajnimi/Deshmi Profesionale</i>
- <i>Karpertier</i>	<i>2 (dy)</i>	<i>Çertifikate trajnimi/Deshmi Profesionale</i>
- <i>Hekurkthyes</i>	<i>2 (dy)</i>	<i>Çertifikate trajnimi/Deshmi Profesionale</i>
- <i>Betonues</i>	<i>2 (dy)</i>	<i>Çertifikate trajnimi/Deshmi Profesionale</i>
- <i>Suvatues</i>	<i>2 (tre)</i>	<i>Çertifikate trajnimi/Deshmi Profesionale</i>
- <i>Plakashtues</i>	<i>2 (dy)</i>	<i>Çertifikate trajnimi/Deshmi Profesionale</i>
- <i>Bojaxhi</i>	<i>2 (dy)</i>	<i>Çertifikate trajnimi/Deshmi Profesionale</i>
- <i>Hidroizolues</i>	<i>2 (nje)</i>	<i>Çertifikate trajnimi/Deshmi Profesionale</i>
- <i>Punonjes Gipsi</i>	<i>2 (dy)</i>	<i>Çertifikate trajnimi/Deshmi Profesionale</i>
- <i>Saldator</i>	<i>1 (dy)</i>	<i>Çertifikate trajnimi/Deshmi Profesionale</i>
- <i>Marangoz</i>	<i>1 (dy)</i>	<i>Çertifikate trajnimi/Deshmi Profesionale</i>
- <i>Shofer</i>	<i>4 (kater)</i>	<i>Leje Drejtimi</i>
- <i>Manovrator</i>	<i>4 (kater)</i>	<i>Deshmi e Aftesise Profesionale (DAP)</i>

Operatori ekonomik duhet të paraqes për stafin e mesiperm: Kontratat individuale të punës, Diplome Universitare/ Diplome e shkolles mesme/ Deshmi te profesionale/ Deshmi e Aftesise Profesionale (DAP)/ Leje Drejtimi sipas shenimeve për çdo kategori të mesipermes si dhe stafi i mesiperm të figurojë në listepagesat e shoqërisë për periudhën Shkurt 2025 - Prill 2025.

V.O- Dokumentacioni (Diplomat/deshmi/certifikatat) që nuk janë leshuar sipas legjislacionit përkatës të arsimit profesional do të konsiderohen jo të sakta dhe behen shkak për veprime të metejshme sipas parashikimeve përkatëse të ligjit të prokurimit publik.

Për profesionet si më sipër, operatori ekonomik duhet të plotesoje tabelën si më poshtë:

Nr.	Emer Mbiemer i punonjesit	Profesioni i punojësit ne certifikate/diplome	Emri i Institucioni publik/privat leshues i certifikates/diplomes	Numri indetifikues i certifikates/diplomes	Nr NIPT - (Ne rast se leshuesi eshte institucion privat)
1					
2					
.....					

Shenim: Kjo kerkese permbushet nepermjet paraqitjes nga operatorët ekonomik te formularit permbledhes te vetedeklarimit sipas shtojces perkatese te DST-se dhe tabelës se mesiperme, te cilat duhet te dorezohen ne fazën e ofertimit ne SPE. Ndersa dokumentacioni provues i kerkuar duhet te paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar, i pari perpara publikimit te njoftimit te fituesit paraprak dhe fillimit te afateve te ankimimit.

KVO verën se bazuar ne piken 1 te nenit 26, te VKM-se nr. 285 date 19.05.2021 “Per miratimin e rregullave te prokurimit publik”, i ndryshuar, parshikohet se: *Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si prove paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose pale te treta, formularin përmbledhës të vetedeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla, dhe per te permbushur kete kriter operatorët ekonomik pjesmarres duhet te vetedeklarojne ne formularin permbledhes te vetedeklarimit sipas shtojces perkatese te DST-se, te dhenat e stafit mbështetes qe disponon sipas percaktimeve te pikes 2.3.4 te DST-se.*

Nga verifikimi i dokumentacionit te paraqitur ne SPE, verehet se operatori ekonomik nuk disponon Teknik Elektrik, Teknik Elektronik, pasi nuk ka deklaruar ne formularin permbledhes te vetedeklarimit diponimin e tyre.

Sa me siper duke qene se OE nuk ka deklaruar ne formularin permbledhes te vetedeklarimit diponimin e stafit mbështetes, ky kriter konsiderohet i papermbushur.

Se dyti, nuk ploteson kriterin 2.3.5 te DST-se ku parashikohet se: *“Operatori ekonomik duhet te disponoje ne pronesi, qira ose kontrate bashkepunimi impiantet si me poshte vijon:*

1 (nje) Impiant prodhimi Betoni

Për impiantin e prodhimit te betonit, ne rast se eshte ne pronesi duhet te jene te pajisur me Akt-Miratimin dhe leje mjedisore QKL Kodi III.1.B. Ne rast se impianti i prodhimit te betonit, eshte me qera ose kontrate bashkepunimi duhet te paraqitet kontrata e qerases/bashkëpunimit. (KVO do te verifikojë nepermjet QKB nese impianti i prodhimit te betonit eshte i pajisur me license 3.1.B, ne rast te kundert OE do te skualifikohet).

Komisioni i Vleresimit te Ofertave verën se per permbushjen e ketij kriteri operatorët ekonomike duhet te disponojne ne pronesi, qira ose kontrate bashkepunimi **“Impiant prodhimi Betoni”** dhe ne rast se eshte ne pronesi duhet te paraqiten Akt-Miratimin dhe leje mjedisore QKL Kodi III.1.B)

ndersa ne rast se impianti i prodhimit te inerteve ose asfaltit eshte me qera ose kontrate bashkepunimi duhet te paraqitet kontrata e qerase ose bashkëpunimit.

Nga verifikimi ne QKB rezulton Operatori Ekonomik nuk disponon leje mjedisore QKL me Kod III.1.B, per **“Impiant prodhimi Betoni”** dhe po ashtu nga verifikimi ne SPE rezulton se Operatori Ekonomik nuk ka paraqitur kontraten e qerase ose bashkëpunimi me ndonje prodhues Betoni.

Sa me siper duke qene se Operatori Ekonomik nuk disponon leje mjedisore QKL me Kod III.1.B, per **“Impiant prodhimi Betoni”**, si dhe duke qene se nuk eshte paraqitur kontrate qiraje ose bashkëpunimi me ndonje prodhues Betoni ky kriter konsiderohet i papermbushur.

Se treti, nuk ploteson kriterin 2.3.13 te DST-se ku parashikohet se: *“Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë deklaratën ku të shprehet se është dakort me mënyrën e financimit të objektit dhe se punimet për realizimin e këtij objekti do të përfundojnë brenda afatit të përcaktuar nga autoriteti kontraktor”*.

KVO thekson se per permbushjen e ketij kriteri operatoret ekonomike duhet te paraqesin deklaratën ku të shprehet se është dakort me mënyrën e financimit të objektit dhe se punimet për realizimin e këtij objekti do të përfundojnë brenda afatit të përcaktuar nga autoriteti kontraktor

Nga verifikimi I dokumentacionit ne SPE rezulton se nuk ka paraqitur asnje dokumentacion per permbushjen e ketij kriteri.

Sa me siper Komisioni i Vleresimit te Ofertave mbeshtetur nenin 77, pika 1, 4 dhe 5, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës. 4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës. 5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve, si dhe ne në nenin 92, pika 3 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet: “Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat

dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji”, vendosi të refuzojë ofertën e OE “NDREGJONI” SH.P.K, për mos përmbushje të kriterëve të vecanta kualifikuese.

Si perfundim, në mbështetje të nenit 92, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, OE “NDREGJONI” SH.P.K me NUIS K31329048I, skualifikohet.

IX- Bashkimi i Operatoreve Ekonomik “RRUGA URA ASFALTIM NR.2 ELBASAN” SH.P.K me NUIS J62904264O & “ZEQILLARI” SH.P.K me NUIS L61912024O & “BLERIMI” SH.P.K, me NUIS J62903384G & “KEVIN KONSTRUKSION” SH.P.K, me Nuis K71401004W,

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur nga Bashkimi i Operatori Ekonomik rezulton se:

Se pari, nuk ploteson kriterin 2.3.1 të DST-se ku parashikohet se: *“Operatorët Ekonomike duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme:*

a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50 % e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës,

ose

b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

- Për kontrata të realizuara me autoritete publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

7. Formularin e vlerësimit;
8. Kontratën/Kontratat;
9. Situacionin përfundimtar;
10. Akt Kolaudimi
11. Faturat tatimore të deklaruara në organet tatimore;
12. Çertifikatën e marrjes në dorezim/ Çertifikatën e perhershme të marrjes në dorezim

-Për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

6. Kontratë sipermarrje;
7. **Leje për kryerje punimesh**
8. Situacionin përfundimtar;
9. Fatura tatimore të deklaruara në organet tatimore;
10. Çertifikatën e marrjes në dorezim/Çertifikatën e perhershme të marrjes në dorezim;

Pika 2.3.1/a plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Kurse pika 2.3.1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Shenim: Per punet e ngjashme te realizuara si BOE krahas dokumenteve te mesiperme duhet te paraqitet edhe kontrata e bashkepunimit ku percaktohet ndarja e zerave te punimeve ndermjet paleve, ndersa per punet e ngjashme te realizuara si nenkontraktor duhet te paraqitet kontrata e nenkontraktimit ku percaktohen zerat e punimeve si dhe miratimi i autoritetit kontraktor/investitorit.

Theksojme se per te permbushur piken 2.3.1, ne lidhje me dëshmitë për pervojen e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë pesë viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, OE duhet te paraqesin dokumentacion per realizimin e puneve te ngjashme me vlere jo me te vogel se 50 % e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet per nje objekt te vetem ose pune te ngjashme ku vlere totale e puneve eshte jo me te vogel se dyfishi i vleres limit te kontrates qe prokurohet. Po ashtu duhet te paraqesin dokumentacionin e kerkuar per kontratat të realizuara me autoritete publike apo per kontrata të realizuara me sektorin privat.

Nga verifikimi i dokumentacionit rezulton se njeri nga operatorët ekonomik pjese e BOE-se konkretisht OE **“RRUGA URA ASFALTIM NR.2 ELBASAN” SH.P.K.**, ka paraqitur si pune te ngjashme vetem nje kontrate të realizuara me sektorin privat, me objekt “Rikonstruksion Hotel “SKAMPA” Elbasan”.

KVO per efekt te percaktimit te dokumentacionit te nevojshem per permbushjen e pikes 2.3.1, te kriterëve te vecanta beri nje verifikim te thjeshte ne faqen zyrtare te Qendres Kombetare te Biznesit www.qkb.gov.al, lidhur me pronesine publike apo private te shoqerise porositese te punimeve me objekt “Rikonstruksion Hotel “SKAMPA” Elbasan” ku nga verifikimi rezultoi shoqeri me 100 % kapital privat.

KVO mban ne konsiderates se per punet e ngjashme të realizuara me sektorin privat, OE duhet të paraqesin: Kontratë sipermarrje, **Leje per kryerje punimesh**, Situacionin përfundimtar, Fatura tatimore, dhe Çertifikaten e marrjes ne dorezim/Çertifikatën e Përkohshme të marrjes.

Nga verifikimi i dokumentacionit ne SPE rezuton se OE **“RRUGA URA ASFALTIM NR.2 ELBASAN” SH.P.K** ka paraqitur Kontratë sipermarrje, Situacionin përfundimtar, Fatura tatimore, dhe Çertifikaten e marrjes ne dorezim por nuk ka paraqitur **Leje per kryerje punimesh**, dokument ky i kerkuar ne kriterin 2.3.1 te Dokumentave Standarte te Tenderit.

Si me siper, duke qene se njeri nga anetaret e BOE-se nuk plotëson kërkesat e parashikuara ne DST për eksperiencat e mëparshme të ngjashme dhe ky kriter konsiderohet i papermbushur.

Se dyti, Nga verifikimi i dokumentacionit ne SPE, rezulton se nuk ploteson kriterin 2.3.10/3, te kushteve te veçanta te kualifikimit ku parashikohet se: *“Operatori ekonomik ne rast se nuk eshte prodhues duhet te paraqese kontrat e furnizimit per materialet si me poshte:*

2.3.10/3 Per Materialet Elektrike:

- Kontrate paraprake furnizimi me prodhuesin ose distributorin e autorizuar. Në rast paraqitje kontrate furnizimi me distributorin zyrtar, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë autorizimin/aktin e marrëveshjes ose cdo dokument tjetër që provon lidhjen midis prodhuesit dhe distributorit zyrtar”.

Nga analizimi i Dokumentave standarte te tenderit verehet se per vendosjen e ketij kriteri Autoriteti Kontraktor eshte bazuar ne zerat e preventivit te punimeve qe do te realizohen dhe rendesise se vecante te objektit te prokurimit duke vleresuar si te nevojshme qe mallrat qe do te perdoren ne realizimin e punimeve te furnizohen nga prodhues apo distributor te autorizuar, kjo ne perputhje me kerkesat ligjore te parashikuara ne pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe ne nenin 39, pika 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”,

Sa analizuam me siper dhe pas shqyrtimit te kriterit dhe qellimit te vendosjes se tij nga ana e Autoritetit Kontraktor, KVO veren se per permbushjen e ketij kriteri OE-te ne rast se ***nuk jane prodhues*** duhet te paraqesin per ***“Materialet elektrike”, kontrate paraprake furnizimi me prodhuesin ose distributorin e autorizuar.***

Në rast paraqitje kontrate furnizimi me distributorin zyrtar, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë autorizimin/ aktin e marrëveshjes ose cdo dokument tjetër që provon lidhjen midis prodhuesit dhe distributorit zyrtar. Per Dokumentacionin ne gjuhe te huaj Operatoret ekonomike duhet te perkthejne kete dokumentacion ne gjuhen shqipe.

Komisioni i Vleresimit te Ofertave veren se operatori ekonomik ka paraqitur ne SPE:

- Per “Materialet Elektrike”, kontrate furnizimi lidhur midis OE “RRUGA URA ASFALTIM NR.2 ELBASAN” SH.P.K dhe subjektit “Brika” Shpk, i cili nga verifikimi ne faqen zyrtare te Qendres Kombetare te Biznesit www.qkb.gov.al nuk rezulton te jete prodhues, por paraqitet ne rolin e distributorit.

Po ashtu nga verifikimi ne SPE, verehet se bashkengjitur kontrates se furnizimit, BOE ka paraqitur nje dokument ne gjuhen angleze, te paperkthyer ne gjuhen shqipe, te cilin e ka paraqitur si autorizim.

KVO veren se ne piken 2, te nenit 24, te VKM-se 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, parashikohet se:

*2. Në rastin e procedurave të prokurimit mbi kufijtë e lartë monetarë, dokumentet e tenderit duhet të hartohen në gjuhët shqip dhe anglisht. Operatorët ekonomikë mund të paraqesin ofertat e tyre në gjuhët shqip ose anglisht. Në **procedurat e prokurimit nën kufijtë e lartë monetarë, gjuha e përdorur është gjuha shqipe.** Në këto procedura, në raste specifike, nëse autoriteti/enti kontraktor*

e gjykon të nevojshme, mund të hartojë dokumentet e tenderit në gjuhët shqip dhe anglisht dhe njofton operatorët ekonomikë se mund të paraqesin ofertat e tyre në gjuhët shqip ose anglisht.

